



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 3665/prot.

Himarë, më 22.05.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 27 , Datë 22.05/2026

PËR

“MIRATIMIN E NIVELEVE KUFIT TË ZHURMËS DHE ORAREVE TË LEJUARA NË ZONAT E USHTRIMIT TË AKTIVITETEVE EKONOMIKE, TURISTIKE DHE ARGËTUESE NË QYTETIN HIMARË”

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2; neni 9.1, pika “a” dhe “b”; neni 23, pika 14; neni 54 dhe neni 55 pika 6, ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”, si dhe në plotësim të Vendimit nr.18, datë 26.06.2024 “Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë” dhe Vendimit nr. 33, datë 27.06.2025 “Për reduktimin e zhurmave në qytetin e Himarës, Bashkia Himarë” të Këshillit Bashkiak Himarë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Miratimin e niveleve kufiri të zhurmës, orareve të lejuara dhe zonave të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në territorin e qytetit Himarë, me qëllim garantimin e rendit publik, mbrojtjes së shëndetit dhe qetësisë publike.
2. Lejohen aktivitetet muzikore me zhurmë të reduktuar, argëtuese dhe përdorimi i pajisjeve audio në subjektet turistike, bare, restorante, beach-bar, clube nate, ambiente të hapura dhe stacionet e plazhit vetëm brenda fashës orare:
 - Nga ora 10:00 deri në orën 20:00.
3. Niveli i zhurmës në mjedise publike, të jashtme apo të brendshme, nuk duhet të tejkalojë kufirin maksimal prej 85 LAeq (dBA) dhe/ose 110 dB LAmaz Fast (dB), sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”.
4. Lejohen aktivitetet muzikore, argëtuese dhe përdorimi i pajisjeve audio në subjektet turistike, bare, restorante, clube nate, ambiente të hapura jashtë zonave të banuara dhe vijës së bregdetit.

5. Subjektet që ushtrojnë aktivitete ekonomike, turistike dhe argëtuese janë të detyruara të marrin masa për kontrollin e nivelit të zhurmës, në mënyrë që të mos cenohen zonat rezidenciale, mjediset publike, strukturat akomoduese, institucionet arsimore, institucionet shëndetësore dhe hapësirat publike.
6. Pas orës 20:00 ndalohet përdorimi i muzikës me volum të lartë, pajisjeve audio, eventeve muzikore dhe çdo aktiviteti tjetër që tejkalon nivelet kufiri të zhurmës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
7. Në raste eventesh kulturore, artistike, turistike, festive apo aktiviteteve të organizuara nga institucione publike ose subjekte private, Kryetari i Bashkisë Himarë ka të drejtë të miratojë, me vendim të veçantë, zgjatjen e orarit të lejueshëm dhe përcaktimin e kushteve specifike për zhvillimin e aktivitetit, duke garantuar respektimin e rendit publik, sigurisë dhe minimizimin e ndikimit të zhurmës në zonat rezidenciale.
8. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë për përcaktimin, miratimin dhe administrimin e hartave të zonave ku ndalohet ose kufizohet përdorimi i muzikës dhe zhurmave, si dhe të zonave ku lejohen aktivitetet muzikore dhe argëtuese, në përputhje me karakterin rezidencial, turistik, publik dhe mjedisor të territorit të Bashkisë Himarë.
9. Bashkia Himarë, Policia Bashkiake dhe strukturat e tjera kompetente ngarkohen për kontrollin, monitorimin dhe matjen e niveleve të zhurmës me pajisje të certifikuara, si dhe për marrjen e masave administrative në rast konstatimi të shkeljeve, në përputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar.
10. Çdo subjekt që shkel përcaktimet e këtij vendimi i nënshtrohet masave administrative sipas legjislacionit në fuqi.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vagjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3665/prot.
2

Himarë, më 22.05. 2026

RELACION:

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE KUFI TË ZHURMËS
DHE ORAREVE TË LEJUARA NË ZONAT E USHTRIMIT TË AKTIVITETEVE
EKONOMIKE, TURISTIKE DHE ARGËTUESE NË QYTETIN HIMARË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-vendimi që po ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim ka si qëllim përcaktimin e niveleve kufi të zhurmës, orareve të lejuara dhe zonave të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në territorin e qytetit Himarë, në funksion të garantimit të rendit publik, mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve dhe ruajtjes së qetësisë publike gjatë sezonit turistik dhe përgjatë gjithë vitit.

Duke marrë në konsideratë zhvillimin e aktivitetit turistik në Bashkinë Himarë, rritjen e numrit të subjekteve që ushtrojnë aktivitete argëtuese dhe përdorin pajisje audio në ambiente të hapura, si dhe ankesat e vazhdueshme të banorëve dhe vizitorëve lidhur me ndotjen akustike, lind nevoja për vendosjen e rregullave të qarta dhe të detyrueshme për administrimin e niveleve të zhurmës në territorin e bashkisë.

I. Baza Ligjore

Ky projekt-vendim mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2; neni 9.1, pika “a” dhe “b”; neni 23, pika 14; neni 54 dhe neni 55 pika 6;
- Ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”;
- Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar;
- Udhëzimin e Përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”;
- Vendimin nr. 18, datë 26.06.2024 “Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë”;

- Vendimin nr. 33, datë 27.06.2025 “Për reduktimin e zhurmave në qytetin e Himarës, Bashkia Himarë”.

II. Qëllimi i projekt vendimit

Ky projekt-vendim synon:

- Përcaktimin e niveleve kufi të zhurmës në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Vendorsjen e fashave orare për ushtrimin e aktiviteteve muzikore dhe argëtuese;
- Garantimin e balancës ndërmjet zhvillimit të turizmit dhe mbrojtjes së qetësisë publike;
- Reduktimin e ndotjes akustike në zonat rezidenciale dhe turistike;
- Forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit nga strukturat përgjegjëse të bashkisë.

III. Përmbajtja e projekt vendimit

Projekt-vendimi parashikon:

- Lejimin e aktiviteteve muzikore dhe përdorimit të pajisjeve audio në subjektet turistike, bare, restorante, beach-bar, clube nate dhe stacionet e plazhit vetëm nga ora 10:00 deri në orën 20:00;
- Ndalimin e muzikës me volum të lartë dhe aktiviteteve që tejkalojnë nivelet kufi të zhurmës pas orës 20:00;
- Zbatimin e kufijve maksimalë të zhurmës prej 85 LAeq (dBA) dhe/ose 110 dB LAmax Fast (dB), sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 2, datë 15.11.2023;
- Detyrimin e subjekteve për marrjen e masave për kontrollin e nivelit të zhurmës;
- Kompetencën e Kryetarit të Bashkisë Himarë për miratimin me vendim të veçantë të zgjatjes së orareve në raste eventesh kulturore, artistike, turistike apo festive dhe për përcaktimin, miratimin dhe administrimin e hartave të zonave ku ndalohet ose kufizohet përdorimi i muzikës dhe zhurmave, si dhe të zonave ku lejohen aktivitetet muzikore dhe argëtuese, në përputhje me karakterin rezidencial, turistik, publik dhe mjedisor të territorit të Bashkisë Himarë
- Kontrollin dhe monitorimin e niveleve të zhurmës nga Bashkia Himarë, Policia Bashkiake dhe strukturat kompetente.

IV. Argumentimi dhe përfitimet

Miratimi i këtij projekt-vendimi sjell disa përfitime të rëndësishme për qytetin e Himarës dhe komunitetin lokal:

- Përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët;
- Uljen e ndotjes akustike në zonat urbane dhe turistike;
- Garantimin e një mjedisi më të qetë dhe të sigurt për vizitorët;
- Rritjen e standardeve të administrimit të territorit gjatë sezonit turistik;
- Krijimin e një balancë ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së interesit publik.

V. Përfundime dhe propozim

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, nevojën për administrimin e niveleve të zhurmës në territorin e Bashkisë Himarë dhe mbrojtjen e qetësisë publike, propozohet miratimi i projekt-vendimit “Për miratimin e niveleve kufi të zhurmës dhe orareve të lejuara në zonat e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në qytetin Himarë”.

Këshilli Bashkiak Himarë ftohet të shqyrtojë dhe miratojë këtë projekt vendim

DREJTORIA JURIDIKE
DREJTORI
Ardit Muhametaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3532 prot.

Himarë, më 01.07. 2024

VENDIM

Nr. 18 Datë 26.06 2024


**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT DHE HARTAVE STRATEGJIKE
PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË BASHKINË E HIMARËS”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, neni 8, pika 2, neni 9.1, pika 1. edhe 1.b, neni 23, pika 14, në Ligjin Nr.93/2015 “Për turizmin”, në Ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” *i ndryshuar*, në Udhëzimin Nr.2 datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike shoqërore” neni 8 si edhe në propozimet e subjekteve të ndryshme që operojnë në fushën e hotelerisë dhe turizmit: Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e datës 26.06.2024 pasi shqyrtoi materialin e sjell nga administrata e Bashkisë e miratoi me 14 vota pro, 3 kundër, 0 abstenim dhe si më poshtë vijon:

VENDOSI:

- 1.Miratimin e planveprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë e Himarës.
- 2.Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari dhe administrata e bashkisë Himarë.
- 3.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4929 prot.

Himarë, më 02.07 . 2025

VENDIM

Nr. 33, Datë 27.06,2025

**“PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE NË QYTETIN E HIMARËS, BASHKIA
HIMARË”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, neni 8, pika 2 , neni 9.1, pika l. edhe l.b, neni 23, pika 14 , në Ligjin Nr.93/2015 “Për turizmin”, në Ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” *i ndryshuar*, në Udhëzimin Nr.2 datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike shoqërore” neni 8 si edhe në propozimet e subjekteve të ndryshme që operojnë në fushën e hotelerisë dhe turizmit:

Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e datës 27.06.2025 pasi shqyrtoi propozimin e kërkesës së Kryetarit të Bashkisë Himarë (kërkesë gojarisht), Këshilli e miratoi me katërmëdhjetë (14) vota pro , tre (3) kundër , zero (0) abstenim dhe si përfundim,

VENDOSI:

- 1.Miratimin për reduktimin e zhurmave në Bashkinë e Himarës.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë , bazuar në ligjin nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3665 prot.

Himarë, më 22.05 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për miratimin e niveleve kufi të zhurmës dhe orareve të lejuara në zonat e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në qytetin Himarë”.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

✓
Himarë

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2; neni 9.1, pika “a” dhe “b”; neni 23, pika 14; neni 54 dhe neni 55 pika 6, ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”, si dhe në plotësim të Vendimit nr.18, datë 26.06.2024 “Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë” dhe Vendimit nr. 33, datë 27.06.2025 “Për reduktimin e zhurmave në qytetin e Himarës, Bashkia Himarë” të Këshillit Bashkiak Himarë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për miratimin e niveleve kufi të zhurmës dhe orareve të lejuara në zonat e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në qytetin Himarë”.
- Relacionin mbi projekt-vendimin “Për miratimin e niveleve kufi të zhurmës dhe orareve të lejuara në zonat e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike, turistike dhe argëtuese në qytetin Himarë”.
- Vendimin nr. 18, datë 26.06.2024 “Për miratimin e planit të veprimit dhe hartave strategjike për reduktimin e zhurmave në Bashkinë Himarë”.
- Vendimin nr. 33, datë 27.06.2025 “Për reduktimin e zhurmave në qytetin e Himarës, Bashkia Himarë”.

KRYETARI
Vangjel Tavo

